

STUDIME E ARTIKUJ

Włodzimierz Pajakowski

LUFTA E PARË ILIRO-ROMAKE (SHKAQET, NDJEKJA, REZULTATET)

Historia e popujve jogrekë dhe e shteteve të Gadishullit Ballkanik në kohët klasike dhe helenistike, me gjithë kërkimet e bëra, me rezultatet e arritura, dhe me përfundime pothuajse të sigurta, akoma mund të thuhet se ka mjaft boshllëqe. Zbrazëti të shumta ka sidomos historia e popujve që banonin pjesën perëndimore dhe qendrore të Gadishullit, që zakonisht emërtohen si degë ose grupe të popujve ilirë. Si problem bazë i këtyre çështjeve del mbi të gjitha mungesa e burimeve të mjaftueshme. Prandaj, është e mundshme që nga mungesa e burimeve të përshtatshme të bëhet në mënyrë të gabuar edhe interpretimi i disa ngjarjeve. Kështu ndodh pikërisht sa i përket paraqitjes së çështjes së Luftës së I të Romës me ilirët, të përcaktuar dikur si gjë eufemistike „Intervenca e parë e Romës në Iliri”, e cila vendosi hapin e parë të Romës në rrugën pushtuese të Lindjes helenistike. Deri tani, megjithëse në temën e këtyre ngjarjeve u krijua një literaturë e bollshme, nuk janë sqaruar si duhet të gjitha shkaqet dhe nuk janë shfrytëzuar të gjitha të dhënat. Shumë shpesh ndodh që përfundimet e historiografisë moderne nuk janë shumë larg nga tezat me tendencë propagandistike të paraqitura nga historiografia nacionaliste e Romës. Prapëseprapë, jo vetëm në tendencën e historiografisë romake, por edhe në pranimin shpeshherë pa farë kritike të tezës së historiografisë së re romake, gjendet thelbi i çështjes. Historiografia e kohëve të reja, duke marrë në vështrim temën e ilirëve, për shkak të të metave në fushën e burimeve të kërkimeve, më në fund e humbi nga horizonti i pikëvështrimit të saj çështjen kryesore të ngjarjeve në Iliri — popullin ilir. Si rezultat i kësaj, vendin e tyre, si çështje kryesore, e zunë popujt e tjerë, të cilët në të vërtetë luajtën një farë roli në historinë e Gadishullit Ballkanik, por është e qartë se ato luanin rol të dytë në krahasim me ilirët. Ja një shembull nga metodat kërkimore dhe rezultatet që sollën ato në historiografinë ilire:

Që më parë G. Zippel,¹ autor i parë i kohës më të re që bëri sintezë mbi ngjarjet e ilirëve, vendosi pikëpamjen se gjoja si shkak i Luftës së I

¹ G. Z i p p e l, *Die römische Herrschaft in Illyrien bis auf Augustus*, Leipzig 1877 (cyt. G. Zippel).

romake me ilirët ishte veprimtaria pirate ilire, e cila i kërcënohej pavarësisë së shteteve greke, po ashtu dhe interesave të Romës. Për këtë ilirët atakonin ardianët. Ky popull në fillim banonte në veri të lumit Narona /sot Neretva/, d.m.th. në jug të Dalmacisë. Në gjysmën e shekullit të III para erës sonë, ardianët për një kohë të shkurtër pushtuan territore të gjera që nga Dalmacia në veri e gjer në Epir në jug. Nën sundimin e tyre u gjendën dalmatët. Ata shkatërruan gjithashtu edhe shtetin e ilirëve taulantë. Në ekspansionin e tyre në jug dhe në lindje, në thellësi të Ilirisë, ardianët u penguan nga dardanët. Shkak kryesor i grindjeve ishin popujt-dasaretë, ardianë dhe fqinjët e tyre. Apogeumi i shkëlqimit të ardianëve i takon kohës së sundimit të Agronit dhe Teutës, të vesë së Agronit.² Përfundimet e G. Zippelit u mbështetën në të dhënat e D. Kasit dhe J. Zonaras, të cilët Agronin dhe Teutën i përcaktonin si udhëheqës të /S/ ardianëve.³ Pikëpamjet e G. Zippelit përsa i përket vendit të ardianëve dhe rolit që ata luajtën në atë kohë, shkenca e kohës së re, me pak përjashtime, i aprovoi.⁴ Hulumtuesit⁵ e tjerë, duke u bazuar në të dhënat më të afërta të këtyre ngjarjeve, të Polibit dhe të Apianit,⁶ të cilët Agronin dhe Teutën, i përcaktonin si udhëheqës të ilirëve, duke marrë parasysh faktin se, në përpjekjet e ardianëve në Romë, në vitin 229 p.e.s. — që i takonin gjithashtu përfundimeve të Luftës së I të Romës me ilirët, shteti ilir akoma ekzistonte, nën sundimin e pasardhësve të Agronit, i quanin ata si udhëheqës të ilirëve. Vlen gjithashtu të shtohet se, duke i lënë anash të dhënat e J. Zonarës dhe D. Kasit, në burime të tjera, këta janë theksuar gjithmonë si ilirë.⁷ Kështu, pra, përcaktimi i G. Zippelit dhe i atyre që i pranuan këto, na del i dyshimtë. Deri sa të kalojmë në temën përkatëse, detyrohemi të sinjalizojmë këtu kontraditat, format dhe burimet e interpretimit në zgjidhjen e tyre. Në rast të kundërt, me të vërtetë del se motivet e çështjeve romake na zhduken nga pikëvështrimi ynë, ose do t'u

² G. Z i p p e l, faq. 38, 44, 45, 46, 52.

³ C a s s i i D i o n i s C o c c e i a n i, *Historiarum Romanarum quae supersunt*. Ed. U. Boissevain, Berolini 1895, XII, frg. 49, 2. 3; J o a n n i s Z o n a r a e, *Epitomae Historiarum*. Ed. L. Dindorfins, Lipsiae 1875, VIII, 19.

⁴ Rrjeshtim të mjaftueshëm mbi literaturën e veprës lexuesi gjen në artikullin tim „Ardianët dhe Ilirët” të dhënë në shtyp në librin për kujtim të prof. dr. G e r a r d L a b u d a me titull „Ars Historii” Poznań.

⁵ K. M a n n e r t, *Geographie der Griechen und Römer*. VII Theil. Landshut 1812, faq. 307-313; J. G. D r o y s e n, *Gehichte des Hellenismus*, t. III/2, Gotha 1878, faq. 43; p o k y: *Das Dardanische Fürstenthum*. W: *Kleine Schriften zur alten Geschichte*. Bd. I. Leipzig 1893; J. L e l e w e l, *Popujt në tokat sllovene para krijimit të shtetit polak*. E përpunuan K. T y m i e n i e c k i dhe H. C h l o p o c k a. Warszawa 1972, sipas indeksit s. v. *Ilirët*; F. P a p a z o g l u, *Les origines et la destinee de l'Etat Illyrien*. W: „Historia”, Wiesbaden 1965, s. 143 i n.

⁶ *Polybii Historiae*. Ed. Th. Bütnner — Wobst. Lipsiae 1882, II, 4 (cyt. Pol). A p p i a n i, *Historia Romana*. Ed. L. Mendelsohn. Lipsiae 1879-1905, *Illyrica*, c. 7 (cyt. App. I 11.) Krahaso gjithashtu: C l a u d i i A e l i a n i, *Varia Historia*, Ed. Mervin R. Dils, Leipzig 1974, II, 41; A t h e n a e i N a u c r a t i t a e, *Dipnosophistarum Libri XV*. Ed. G. Keibel, Lipsiae 1923, X 440 a.

⁷ Pro. I. I. R u s s u, *Ilirii. Istoria-limba si onomastica-somanizarea* Bucuresti 1969, s. v. *Illyrii*.

kushtojmë atyre një rëndësi fare periferike. Është e qartë se, në këtë mënyrë pasojat e Luftës së I romake me ilirët na dalin në proporcione krejt të padrejta. Vërejtjet e më poshtme, duke e rishikuar çështjen e marrëdhënieve të ilirëve me ardianët, lejojnë të formulojmë konkluzione të reja për këtë.

Burimet greke, sa i përket etnosit ilir, gjithmonë atë e dallonin si grup më vete, në gjuhën latine quhen „Illyrii proprie dicti”, që don të thotë ilir me kuptimin e plotë të fjalës. Ngjarjet, që fillojnë nga shekulli VI/V — gjysma e shek. II p.e.s. në kontekstin që na paraqiten ilirët, na lejojnë të konstatojmë se ata padyshim banonin bregun e detit Adriatik, duke përfshirë afërsisht vendin në veri të Epidamit, pak a shumë gjatë lumit Neretva. Propozimi i lokalizimit të vendit ilir gjen përputhje në tekstin e parë, pak a shumë të plotë të bregut Adriatik që është i ruajtur në dorëshkrimet e „Periplus” të P. Skylaksit. Sikundër ka dalë, pikërisht sipërfaqja e qëndrimit të ilirëve ka mbetë e pa korigjuar, dhe si rezultat nga „Periplus” janë hequr ilirët, në vend të tyre janë vendosur taulantët.⁸

Ilirët në jug kishin fqinjë taulantët. Në jug-lindje kufizoheshin me Maqedoninë e Sipërme dhe kishin fqinjë brygamët, të cilët, ka pak mundësi, që të mund të përbënin bashkë një degë të mënjanuar më tepër në lindje të grupit të paionëve. Në veri kishin dalmatët. Më tepër kontraverze paraqitet çështja e fqinjëve nga ana lindore e ilirëve, përse i përket territorit të brendshëm ballkanik. Më tepër ka të ngjarë se në lindje ilirët kishin kufij të përbashkët me ardianët. Identifikimi me shtetin nga ana e poshtme e Neretvës,⁹ në veri ose me Malin e Zi të kohëve të tanishme,¹⁰ që nuk është i lokalizuar saktësisht.

Të dhënat e deritashme, lidhur me çështjen e vendqëndrimit të ardianëve, ose të dhënat jo të plota, paraqitnin zbrazëti por edhe trajtimi i tyre lidhur me këtë temë ishte i gabueshëm. Pra, nuk janë marrë parasysh dhe në mënyrë të mjaftueshme deri tani të dhënat e Strabonit¹¹ sa i përket kufirit të përbashkët ndërmjet ardianëve dhe paionëve. Vendi i ardianëve nga ai i paionëve gjithmonë ka qenë i ndarë nga territori i njohur i dardanëve.¹² Të dhënat e Strabonit gjejnë mbështetje në të dhënat e Polienit, nga të cilat na bëhet e ditur se Aristoni, udhëheqësi i paionëve, i përzënë nga mbretëria e tij prej Lysimahut, shpëtoi duke ikur në vendin¹³ që i përkiste

⁸ Scylacis Caryandensis, *Periplus*. Ed. C. Müllerus. W: *Geographi Graeci Minores*, t. I. Parisii 1882, c. 26 (cyt. Scyl.). Por W. Pajakowski, *Epir*. Studia. Poznań 1970, s. 27 i n. Por (barazim) me artikullin „Ardianët dhe Ilirët”.

⁹ Barazo si më sipër, pika 4.

¹⁰ F. Papazoglu, *O teritoriji ilirskog plemena Ardieja*. W: *Zbornik Filozofskog Fakulteta*. Beograd VII, 1963, 1, s. 71-86. Kësaj; *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*. Sarajevo 1969, sipas indeksit s.v. *Ardiaei*. Harta

¹¹ Strabonis, *Geographica*. Ed. A. Meineke, I-III, Lipsiae 1895-1913, VII, frg. 4 (cyt. Str.).

¹² Barazo F. Papazoglu, *Plemena*, harta.

¹³ Polyaeeni, *Strategematon libri octo*. Ed. E. Wölffin. Lipsiae 1894, VII, 4. *Andotatio critica*, s. LX, 165: (cyt. Polyaeen).

me siguri ardianëve, të cilët dikur quheshin sardiej, si dhe vardej.¹⁴ Si rezultat i kësaj dardanëve iu njoh territori që i takonte ardianëve, ndërsa këta u shlyen nga harta e këtyre vendeve. Në këtë mënyrë, dardanëve iu njohën territore më të largëta, të cilat në të vërtetë i takonin ardianëve. Duke e hedhur poshtë këtë korrigjim (lat. emendatio) të pa bazë, na del pranimi i të dhënave të Strabonit, e si konsekuencë pranimi i ekzistencës së kufijve të përbashkët ndërmjet vendeve të ardianëve dhe të paionëve. Në këtë mënyrë ardianët i zëmë si fqinjë të paionëve, por edhe të ilirëve, nga ana e perëndimit, gjë që bazohet në ngjarjet e lidhura me Luftën e I romake me ilirët, për të cilën do të flasim më poshtë. Në lindje ardianët kishin kufi të përbashkët me dardanët. Pak a shumë e komplikuar është çështja e fqinjëve të ardianëve në veri. Në fillim me siguri këta ishin autariatët, kurse pas lëvizjes së autariatëve, që ndodhi si përfundim i ekspansionit të keltëve në gjysmën e shekullit IV/III p.e.s., do të thotë pak kohë para invazionit kelt të vitit 289 /279, ardianët siç duket ranë në kontakt me disa fise panone. Në atë kohë autariatët u bënë fqinjë të anës veri-lindore të ardianëve. Me gjithë këtë duket se pas Luftës së III romake me ilirët (lufta me Gencin), e sidomos pas sulmit të Romës kundër dalmatëve në vitin 155 p.e.s., ardianët u tërhoqën në breg duke u vendosur në të dy anët e Neretvës dhe duke rënë në këtë mënyrë në kontakt me dalmatët. Bregun e pushtuan siç duket në kohën e sulmit të Oktavianit në Iliri në vitet 35-33 p.e.s.¹⁵ Ka mundësi që lëvizja e ardianëve në bregun e Adriatikut të ketë ndodhë më herët d.m.th. në kohën e rivalizimit të ilirëve dhe maqedonve në kohën kur në Maqedoni mbretonte Filipi i V, kurse në Iliri udhëheqte Skerdilaidi, që në atë kohë ishte mik i Romës. Nga të gjitha këto që u thanë deri tani mbi çështjen e vend-qëndrimit të fqinjëve të ardianëve, del se këta duhet t'i konsiderojmë si një nga banorët e Ballkanit qendror, sikundër dhe autariatët, dardanët, tribalët e mezët. Vend-qëndrimin fillestar të ardianëve duhet ta vëmë në territorin që përmbledh pjesën perëndimore të Jugosllavisë së tanishme, Maqedoninë, pastaj pjesën perëndimore të Kosovës, Dukagjinin, pjesën veri-lindore të Malit të Zi, dhe poashtu me siguri pjesën lindore të Shqipërisë. Ardianët pra banonin në brendi të kontinentit. Territori i shtrirjes të tyre, i propozuar më sipër, gjen edhe një përkrahje nga pozita e një krahine ilire me emër „Ardia” pa dyshim vend i ardianëve — për të cilën shkruan Straboni,¹⁶ se gjendet në brendi të kontinentit, po në anën e kthyer kah deti Adriatik.

Nga ajo që u tha më sipër mbi çështjen e vendit të shtrirjes së ardianëve dhe të ilirëve, në të vërtetë ato i bien ndesh konceptit të G. Zippel, i cili nuk e shtron qenien e popullit me emrin ilirë. G. Zippel, sipas konceptit të tij për historinë e ilirëve, si bazë të kësaj historie mori popullin e ardianëve, në të vërtetë ata ishin vetë ilirët. Koncepti i G. Zippelit del siç duket nga propozimi i tij sa i përket qëndrimit të ardianëve ose nga të dhënat e J.

¹⁴ Barazo I. I. R u s s u, *Iliri*, s. v. *Ardiaei*.

¹⁵ Barazo W. P a j a k o w s k i, *Ardianët dhe Ilirët*.

¹⁶ Faq. VII, 5. 1.

Zonarës dhe D. Kasit, të cilët Agronin dhe Teutën i quanin udhëheqës të ardianëve, kurse burimet e kohëve të reja ata i vënë në krye të ilirëve.

Rezultatet e fituara në kërkimet shkencore pas gjysmës së parë të shekullit të XIX dhe të kërkimeve më të reja vërtetojnë, se Mbretëria e ilirëve u formua në shekujt V/IV p.e.s.. Themelues qe Bardhyli/I.?.¹⁷ Gjatë kohës së sundimit të Bardhylit, ilirët i kundërshtuan ekspansionit të Sirakuzës të zhvilluar nga Dionisi i I, pastaj me sukses intervenuan në çështje të brendshme në Maqedoni dhe në Epir. Bardhyli, me siguri, vuri nën sundimin e tij territore të gjëra si dhe fise, që nga Epiri në jug, gjer në Dalmaci në veri. Në lindje për një kohë sundoi mbi Maqedoninë e Epërme, ka mundësi bile edhe vendin e paionëve dhe të ardianëve. Për atë kohë dhe në ato kondita, ai qe një shtet i gjerë, të paktën qe influenca e tij e gjërë. Këtë oreks të parë, oreks të ekzistimit të shtetit ilir e shuajti lufta e madhe me Filipin e II, i cili e mundi Bardhylin. Fitorja e Filipit të II nuk qe e barabartë me humbjen e përhershme të Ilirisë. Ilirëve, sundimin e tyre ia imponoi Monarkia e argeadëve, më vonë, pas luftërave të gjata që bënë ilirët nën udhëheqjen e djemëve ose vëllezërve të Bardhylit, Grabonit dhe Pleuratit. Pas vdekjes së Filipit të II, ilirët organizuan kryengritje, në krye të të cilës qëndroi Kliti, i biri i Bardhylit dhe udhëheqësi i taulantëve — Glauku. Aleksandri i Madh e shtypi kryengritjen. Nën ndikimin maqedon, ilirët mbetën deri në vdekjen e Antipatrit. Më vonë u gjendën për një kohë nën influencën e Glaukut, udhëheqësit të taulantëve, i cili vazhdoi luftë të gjatë me Kasandrin. Vdekja e Glaukut /rreth vitit 301 p.e.s.?, pas luftës së humbur më në fund me Kasandrin, thekson ekzistenën e mbretërisë së vogël të taulantëve dhe hegjemoninë e shkurtër maqedone në Iliri. Këto dy fakte lehtësojnë ekspansionin e Monarkisë se aiakidëve nga Epiri, ku përfaqësuesi më i njohur qe Pirrua. Pirrua duke përfituar nga përzierjet në Maqedoni, pas vdekjes së Kasandrit, bashkoi në monarkinë e tij territorin që mbeti pas mbretërisë së taulantëve, si dhe popuj të tjerë fqinjë në këtë mbretëri. Marrëdhëniet e Pirros me udhëheqësit e ardhshëm ilir dhe në përgjithësi me ilirët, nuk dalin të qarta. Ka mundësi pra, që udhëheqësi ilir me emrin Bardhyl të njohë autoritetin e Pirros, për të cilën na flet fakti se Pirrua mori për grua të bijën e tij që quhej Birkena. Nga emri i tij Bardhyli mund të ishte djali i Klitit, birit të Bardhylit të I, krijuesit të shtetit ilir. Gjatë sundimit të pasardhësit të Bardhylit /të II?/, Monunit, ilirët siç duket u liruan nga influenca e Pirros. Se ngjarjet e asaj kohe u zhvilluan kështu, na del nga fakti i pjesëmarrjes së Monunit në anën e Lysimahut, në kohën, kur ky bëri luftën fitimtare me Pirron. Pak më vonë, pas vdekjes së Lysimahut, Monuni vazhdoi luftën me Ptolemej Keraunin, i cili ra në marrëveshje me Pirron. Pirrua atëherë hoqi dorë nga pretendimet për pjesën perëndimore të Maqedonisë, si shkëmbim për ta ndihmuar në përgatitjet që do të bënte për t'i rënë Italisë, ku po i shkonte në ndihmë

¹⁷ Këtyre çështjeve i kushtoj një rëndësi më të saktë në përgatitjen e artikullit për shtyp me titull „Shtetërimi i ilirëve.”

Tarentit. Pa tjetër në këtë rast ndodhin disa ngjarje të rëndësishme, përfundimi i të cilave indirekt ose direkt vendos përmbushjen e disa konditave kryesore sa i përket rilindjes së plotë të Monarkisë ilire.

Një shkak tjetër i kësaj rilindjeje që me siguri dhe kriza e monarkisë sirakuziane, e cila në kohën e pasardhësve të Dionisit të I, sidomos pas vdekjes së Agathoklit u shkatërrua. Në këtë moment lidhet edhe baza e detit Adriatik, e detit Jon, zhduket gjithashtu flota e plotfuqishme sirakuziane. Në kohën e ndeshjes në Itali, fuqinë më të madhe në detin Jon dhe Adriatik e kishte me siguri Pirrua. Po në këtë periudhë del edhe shkak i dytë i rilindjes së Monarkisë ilire. d.m.th. në vitin 280/279 p.e.s., nëpër Gadishullin Ballkanik kaloi invazioni i përgjithshëm e i njohur kelt. Në të vërtetë ai përfshiu edhe Ilirinë,¹⁸ por me më shumë përfundime negative përfshiu Maqedoninë. Në luftë me keltët, në kohën kur udhëheqës i Maqedonisë ishte Ptolemej Kerauni, Maqedonia, ra për një periudhë të gjatë në një krizë të brendshme. Në këtë kohë, Pirrua, i cili nuk ia arriti qëllimit të tij në Sicili e në Itali, duke përfituar nga dobësia e shtetit maqedon, provon dhe atakon haptas në vitin 274 gjatë sundimit të Antigoni Gonatit, ta marrë Maqedoninë, gjë që pjesërisht ia arrin për një kohë. Monarkia e aiakidëve kishte arritur në atë kohë apogeun e mrekullueshëm. Kurse në këtë kohë lufta me Antigoni Gonatën e shpie Pirron në Peloponez, ku në luftë për Argon gjeti vdekjen. Ka mundësi që kjo ngjarje të jetë shkak i rëndësishëm për rilindjen e Monarkisë ilire. Katastrofa në Peloponez përpak bëri që Monarkia e aiakidëve të shkatërrohej krejtësisht. Me radhë nga ajo largohen etolët, atamanët, akarnanët, ishujt jonik, pjesë të shtetit grek. Vlen këtu të përmendet sidomos ngritja e etolëve, të cilët luajtën një rol negativ në historinë e kohës së fundit të Monarkisë së aiakidëve. I biri i Pirros, Aleksandri i II arriti pjesërisht ta ndalojë procesin e shkatërrimit të Monarkisë së aiakidëve, edhe më tepër, duke përfituar nga angazhimi i Maqedonisë në luftën hermonide, e sulmoi atë dhe përpak që s'e mori. Më në fund u zbraps nga Maqedonia prej Demetrit të II shumë të ri, birit të Antigoni Gonatës dhe humbi me radhë për një kohë mbretërinë e tij, Epirin /rreth vitit 264 p.e.s.?. Në këtë periudhë ilirët siç duket ishin të miqësuar me Maqedoninë. Gjatë sundimit të Aleksandrit II udhëheqësi ilir, Mytili, sulmon Epirin, por detyrohet përsëri të tërhiqet. Aleksandri i II pasi mori fuqinë në shtet bashkë me etolët vazhdoi luftën kundër akarnanëve, tek të cilët fitoi pjesën perëndimore të vendit të tyre. Kështu, pak a shumë shkurtimisht, na paraqiten marrëdhëniet ndërmjet ilirëve me maqedonasit dhe epirotët në periudhën nga viti 280 e pas 234/233 p.e.s..

Ndërsa invazioni kelt i vitit 280/279 p.e.s., prej së cilit u dobësua mjaft Maqedonia, tërhoqi me vete përfundime të tjera, nxori në shesh forcën e popujve të tjerë ballkanikë, të cilët në kohën e hegjemonisë në Maqedoni gjatë sundimit të Filipit të II dhe Aleksandrit të Madh, i dhanë

¹⁸ P a u s a n i a e, *Graeciae Descriptio*. Rec. F. Spiro. Lipsiae 1903, I, 19.

autoritet shtetit maqedon. Një nga fqinjët e maqedonasve ishin dardanët. Lidhja e tyre pas tërheqjes së keltëve filloi të luajë rol të madh në historinë e këtyre krahinave. Ekspansioni i dardanëve u kthye në fillim kundër fqinjëve më të afërt, tribalëve. Pak më vonë dardanët, nën drejtimin e udhëheqësit të parë historik të vendit të tyre — Longarit, kthehen kundër mbretërisë së vogël të paionëve, fqinjëve verior të maqedonasve. Mbretëria e paionëve, historia e të cilëve nuk është studiuar aq mirë si dhe ajo e mbretërisë së ilirëve, u krijua gjithashtu në gjysmën e shekujve V/IV p.e.s. Gjatë sundimit të Bardhylit /I?/ ka mundësi që ajo të varej nga mbretëria e ilirëve. E zaptuar më vonë nga Filip i II, ajo varej nga Maqedonia dhe mbeti kështu deri në vdekjen e Antipatrit. Në kohën e Lysimahut ajo ishte nën sundimin e Maqedonisë, e pas invazionit kelt më në fund fitoi pamvarsinë. Pas vdekjes së Pirros ata kishin ndërmend përsëri ta pushtonin Paioninë; udhëheqësit e Paionisë duke u mbrojtur para ekspansionit maqedon, gjetën, siç duket, miq në pikëpamje antagoniste me Maqedoninë, Lidhjen Etole.¹⁹ Në këtë kohë dardanët, duke përfituar nga dobësia e Maqedonisë, në kohën e angazhimit të saj në çështjet greke, vetë të parët i ranë Paionisë, gjë që ndodhi para se të kalojnë 30 vjet të shekullit të III p.e.s.. Ky fakt i bëri dardanët — ashtu sikur vërtetojnë më vonë marrëdhëniet e tyre — fqinjët më të rrezikshëm për Maqedoninë. Për Maqedoninë, angazhimi i të cilës në Greqi ishte i rrezikuar nga Lidhja Etole dhe Lidhja e ahejve, lufta me dardanët për Paioninë ishte një rrezik i veçantë. Derisa, dardanët i kërcënoheshin jo vetëm paionëve, të cilët më në fund i shtypën sikundër dhe maqedonët, me të cilët rivalizoheshin për Paioninë, ata kishin ndërmend gjithashtu të sulmojnë fqinjët e tyre, ardianët.

Si u përcaktua më sipër, ardianët duhet t'i vendosim në kompleksin e popujve të pjesës qendrore të Ballkanit, kështu dhe historia e tyre është një pjesë e historisë së këtij kompleksi popujsh, gjë që nuk i largon ata nga historia e fqinjëve të tyre, ilirëve, si dhe të atyre pak më të largët maqedonasve. Se historinë e ardianëve duhet t'a shqyrtojmë të lidhur ngushtë sidomos me historinë e popujve të Ballkanit të Mesëm, na e nxjerrin të dhënat e Strabonit,²⁰ të cilat për ardianët, autariatët, tribalët, dardanët, lojë, skordiskët thonë se dikur qenë popuj shumë të fuqishëm, por për shkak të luftërave të pandërprera ndërmjet tyre dhe më vonë me maqedonët dhe romakët, ata humbën rëndësinë e tyre, më nuk përmenden, ose luanin një rol shumë të vogël në ato kohë. Një ndër aktivitetet e ardianëve, që lufta e tyre me autariatët, të cilën siç duket duhet ta vendosim në kohën para invazionit kelt, filloi pas shkatërrimit të Monarkisë së argeadëve. Më mirë shquhet ajo me momentin e shkatërrimit të lidhjes së autariatëve me keltët, që ndodhi rreth vitit 310 p.e.s.. Ka mundësi që ardianët, në kohën e sundimit të Bardhylit të I, ishin më shumë të lidhur me ilirët, ndërsa duke filluar që nga Filip i II hynë në fushën e influencës së Maqedonisë. Në kohë të sundimit

¹⁹ Gjenezën e këtij bashkimi e bazoj në një ndër artikujt e ardhshëm.

²⁰ Faq., VII, 5, 11.

të Lysimahut, d.m.th. pak para invazionit kelt të vitit 280/279, ardianët ishin të pavarur, gjë që e thotë fakti i arritjes së Aristonit tek ata, udhëheqësit të paionëve, i cili u dëbua nga mbretëria e tij prej Lysimahut.²¹ Në kohën e invazionit kelt të viteve 280/279 ardianët, me siguri për një kohë të shkurtër, iu-nënshtuan keltëve, pastaj, siç duket, përsëri fituan pavarësinë. Me siguri, rrezik më i madh për ta ishte fuqia e madhe e ilirëve, megjithëqë nuk ka dyshim, se për nënshtimin e tyre përpiqeshin gjithashtu dardanët. Në të vërtetë nuk dimë shumë gjëra me saktësi sa i përket luftës mes dardanëve me ilirët, për zotësimin mbi ardianët, por, pa asnjë dyshim, ajo mbaroi me humbjen e dardanëve. Ja disa të dhëna për sundimin e ilirëve mbi ardianët: „Në kohën e sundimit të Teutës dhe në kohën kur ajo do të sulmonte Epirin, ndodhën kryengritje të brendshme nga popuj që sundoeshin prej saj, të cilët u hodhën në anën e dardanëve”.²² Pastaj, në kohën e Luftës së I romake me ilirët, këta të parët duke u futur thellë në pjesët që gjendeshin thellë në Iliri, nënshtuan ardianët.²³ Më në fund, në kohën e Luftës I Maqedone, në të cilën pjesëmarrësi më aktiv nga ana romake, qe sundimtari i ilirëve, Skerdialidi, Filipi i V e zaptonte vendin e ardianëve.²⁴ Sikur shihet më lart, ardianët ishin në atë kohë shkak i grindjeve ndërmjet maqedonasve dhe ilirëve. Këto ngjarje na vërtetojnë se populli që bëri kryengritje kundër Teutës, mund të ishin vetëm ardianët. Vetëm ata, për arsye të pozitës së territorit të tyre, mund të kalonin në anën e dardanëve. Zotërimi i ardianëve nga ilirët, ka mundësi të ketë ndodhur qysh në kohën e sundimit të Mytilit. Dihet se ky tregoi një aktivitet të dukshëm në luftë me Aleksandrin e II-të, dhe aq sa u tregua aktiv në terrenin e Epirit, aq më me lehtësi e drejtoi pushtimin ekspansionin në thellësi të Gadishullit Ballkanik. Ekspansioni në këtë kohë në Gadishullin Ballkanik nuk paraqiste vështirësi të mëdha, sepse autariatët, një ndër popujt më të fuqishëm të asaj kohe, ishin të shkatërruar nga keltët, dhe kishin lënë vendin e tyre të vjetër i cili gjendej afër vendeve ilire, dhe ishin futur në thellësi të Gadishullit Ballkanik. Dardanët, megjithëse shkenca e re u jep atyre rol të madh në historinë e Gadishullit Ballkanik, gjatë sundimit të tyre mbi ardianët, mbetën prapa nga ilirët. Sundimi mbi ardianët u dha udhëheqësve ilirë bazë të mrekullueshme për t'a filluar luftën për Paioninë, mbi të cilën me siguri zotëronin dardanët. Kjo del edhe nga ngjarjet e kohës, pas intervenimit të II-të romak në Iliri, atëherë kur u bë lufta ndërmjet udhëheqësit ilir, Skerdilaidit me Filipin e V-të. Ky i pari pretendoi në atë kohë ta sundojë Pellagoninë,²⁵ që ishte pjesë e pavarur e maqedonasve paionë. Të gjitha këto e pasqyrojnë fuqinë e madhe të ilirëve dhe rrezikun që paraqiste kjo fuqi për dardanët. Bartës kryesorë të ngjarjeve ishin ilirët, dardanët dhe maqedonasit, kurse

²¹ P o l y a e n ., VII, 4.

²² Pol., II, 6

²³ Pol., II, 8.

²⁴ T i t i L i v i i, *Ab urbe condita*. Ed. M. Wissenborn. Lipsiae 1906, XXVII, 30/cyt. Liv./.

²⁵ Pol., V. 108.

ardianët, si dhe paionët ishin vetëm shkaktarë të ngjarjeve. Fuqia e ilirëve do të çfaqej në tërësi në anën e kundërt të Gadishullit Ballkanik.

II

Një ndër shkaqet pak a shumë që ndikuan në mënyrë aktive në situatën politike të Gadishullit Ballkanik në gjysmën e parë të shekullit të III-të para erës sonë ishte Monarkia e aiakidëve. Pas vdekjes së Aleksandrit të II-të, në radhë të parë e shoqja e tij e njëkohësisht motra /motër nga nëna ose babai — Olimpia/, si edhe djemtë e saj — Pirrua i II-të dhe Ptolemeu — të cilët vdiqën para kohe, nuk qenë në gjendje t'ia dalin në krye krizës së brendshme që sa vinte e shtohet, e në të cilën bënin pjesë rritja e separatizmit të plemioneve dhe tendenca demokratike. Veçanërisht ishin në gjendje të përballonin armiqtë e jashtëm, sidomos etolët. Olimpia, duke pasur dëshirë të përfitojë nga ndihma maqedone në luftë kundër etolëve për mbrojtjen e Akarnanisë Perëndimore, arriti ta martojë vajzën e saj me Demetrin e II-të.²⁶ Në anën tjetër, akarnanët duke e ndier rrezikun nga veprimet ekspansioniste të etolëve dhe duke mos u besuar njëkohësisht aiakidëve, iu drejtuan siç duket Senatit romak për ndihmë. Senati gjoja ua ndaloi etolëve tërheqjen e trupave të tyre nga Akarnania.²⁷ Fundin e Monarkisë së aiakidëve e përcakton kryesisht vdekja e Deidameias, trashëgimtares së fundit të fronit. Nga ky moment, Symahia e epirotëve, në të cilën bazohej monarkia, e aiakidëve, e cila pa dyshim përfaqësonte një strukturë politike më të forcuar, mbeti e zëvendësuar me një Lidhje /koinon/ më të çthurur të epirotëve me qendër në Foinikë /Chaonia/. Disa pjesë përbërse dhe të varura të ish Monarkisë së aiakidëve mbeten edhe për një kohë në Lidhjen e epirotëve, kurse të tjerët ndahen në jetë politike të pavarur.

Shpërndarja e Monarkisë së aiakidëve përbën përmbushjen e konditës së fundit të rilindjes së plotë në Monarkinë ilire. Në radhë të parë sunduesit e ilirëve u kujdesën që t'ia imponojnë sundimin e tyre banorëve të asaj pjese të Ilirisë, e cila i nënshtrohej aiakidëve. Ky vërtetim del i qartë në të dhënat e Apianit, i cili lidhur me veprimet e ilirëve dhe sa i përket Agronit, si sundues i ilirëve, thotë se ai qe mbret i asaj pjese të Ilirisë që gjendej mbi detin Jon, mbi të cilën sundonte dikur Pirrua dhe pasardhësit e tij. Me kohë Agroni zotëroi disa pjesë të Epirit, mbi të gjitha ishullin e Korfuzit /Korkyra/, Farit si dhe qytetet Epidam dhe Apolloninë, ku vendosi trupat e tij. Një pjesë e të dhënave të Apianit këtu nuk është krejt e saktë". Mbretëria e Agronit nuk u krijua në terrenin që dikur ishte nën sundimin e Pirros. Ky siç dihet, sundonte mbi territore të ish Mbretërisë së

²⁶ Miniani Iustini, *Epitoma Historiarum Philippicarum Pompei Trogi*. Ed. F. Ruhl, Lipsiae 1907, XVIII, 1 /cyt. Just./.

²⁷ Just., XVIII, 1, 2.

taulantëve, të cilat ishin diçka krejt të ndryshme nga Mbretëria e ilirëve, si kryetar i të cilëve qe pikërisht Agroni. Kurse Agroni, sidomos Teuta, pas vdekjes së Deidameas, me siguri e rikthyen fuqinë mbretërore ilire në territorin e taulantëve dhe fqinjëve të tyre, atinatanëve. Argumentet e zhvillimit të ngjarjeve do t'i përmendim më poshtë në lidhje me sulmin e Teutës në Epir. Bashkimi i taulantëve me arintanët me Monarkinë ilire hapën para saj perspektivën për t'u hedhur në Epir.²⁸

Një ndër ata që vareshin nga Monarkia e aiakidëve pas shpërndarjes së saj, dhe që nuk morën pjesë në Lidhjen epirote, ishin akarnanët. Mirëpo, të ngacmuar nga etolët provojnë të kërkojnë ndihmë në miqësi me Maqedoninë. Maqedonasit patjetër do t'u vinin shpesh në ndihmë, sikur të mos ndodhte disfata (humbja) me përfundime fatale, që patën ata në atë kohë nga forcat e dardanëve. Etolët, duke u orientuar mbi pozitën e maqedonasve filluan rrethimin e Medionit, qytet i akarnanëve, duke dashur t'i detyrojnë ata të bëjnë pjesë në lidhjen e tyre. Sipas Polibit, i cili për këtë qe i informuar mirë, rastet e mëvonshme ndodhën pothuaj sipas planit të caktuar nga sunduesi i Maqedonisë, Demetri i II; duke mos mundur vetë t'u shpejtojë në ndihmë akarnanëve, ai iu lut Mbretit të ilirëve, Agronit, të birit të Pleuratit, i cili kishte pasur fuqi më të madhe tokësore dhe detare, më shumë se të gjithë sunduesit që, para tij sunduan në Iliri, që të luftonte për shpërblim kundër etolëve. Agroni e mori përsipër detyrën e ndalimit të etolëve nën Medion. Njëqind anije ilire me pesë mijë luftëtarë lundruan pa u vënë re në grykën Ambrakias, duke u shkaktuar disfatë të plotë etolëve nën Medion. Fitorja e arritur papritmas, e sidomos grabitjet e bollshme, i bënë aq kryelartë ilirët, sa që vendosën ta vazhdojnë veprën e filluar me sukses. Këtë detyrë e kreu Teuta, e veja e Agronit, i cili siç duket pak kohë pas fitores mbi Medion vdiq për shkak të alkoholizmit.²⁹ Fitorja mbi Medionin nuk qe çështje e rastit, një rol të madh këtu luajti befasia, respektivisht paraqitja e flotës së ilirëve. Lidhja luftëtare e etolëve, e pathyeshme deri atëherë nga maqedonët, e cila pas shpërthimit të Monarkisë së aiakidëve, pati çdo mundësi ta zotërojë Akarnaninë dhe ta tërheqë në fushën e influencës së vet Lidhjen Epirote, u mund nga ilirët. Fitorja nën Medion eliminoi luftën e etolëve për Epirin. Në këtë mënyrë ilirët hapën rrugën e luftës për Epirin, si dhe Akarnaninë që ishte fqinjë me te, gjë për të cilën përpiqeshin të merrnin masa edhe etolët nga ana e tyre. Duke përfituar nga frytet e fitores nën Medion, ilirët gati menjëherë bënë të varur nga ana e tyre epirotët.

Sipas Polibit, vërshimi i ilirëve në drejtim të Epirit ishte çështje jo dhe aq e rastit. Teuta kish ndërmend siç duket të sulmojë në Peloponez. Megjithëkëtë, ajo në fillim u dha leje atyre që i kishte nën urdhërin e saj, që vetë, në përgjegjësinë e tyre të lëshohen në det, pastaj përgatiti ushtrinë tokësore dhe flotën me urdhëra që të kenë parasysh dhe të konsiderojnë

²⁸ App., III. 7.

²⁹ Pol., II. 2.

çdo vend /shtet/ si armik. Ata patën ndërmend ta boshatisin Meseninë dhe Eleenë. Këto shtete dihet se qysh me kohë ishin boshatisur nga ilirët. Ato vende gjendeshin larg nga deti, e në raste sulmi, ndihma zakonisht nuk arrinte dot. Duke marrë përsipër marshimin e saj, flota e ilirëve gjoja për t'u pajisur me ushqime, zbarkoi në portin jo larg nga kryeqyteti i Lidhjes së Epirotëve, Foinike. Këtu ilirët bënë marrëveshje me galet që gjendeshin si grup ushtarak në qytet, të angazhuar me pagesë nga epirotët. Galët ia dorzojnë qytetin ilirëve.³⁰ Për ta kuptuar qëllimin e ngjarjeve që shoqëruan qëndrimin e ilirëve në Epir, me të cilat Polibi më vonë do të na çojë në shkakun e Luftës së I romake me ilirët, duhet t'u kushtojmë vëmendje galëve, të cilët i tradhëtuan epirotët duke e dorëzuar qytetin në duart e ilirëve. Atyre Polibi u kushton një hyrje të zgjeruar, një gjë pra karakteristike, pas përkrahimit të ngjarjeve të tjera, ai në Epir ishte si observator në atë kohë. Del pra, se galët mbetën të mënjanuar nga vetë popullsia për shkak të thyrjes së besës së dhënë si dhe nga padrejtësitë e tjera. Më vonë, duke qenë në shërbim tek kartagjenasit, çfarosën e plaçkitën qytetin Agrigentum, që ua kishin lënë nën kujdes. Duke qëndruar si grup në qytetin Erikos, provuan t'ia dorëzojnë atë romakëve, por kur tradhëtia e planifikuar doli në shesh, haptas u hodhën në anën e romakëve. Më vonë, duke pasur besimin e romakëve, grabitën tempullin e Afroditës së Ericinës. Pas Luftës /së I/ me Kartagjenën, romakët çarmatosën galët, i futën në anije dhe i çuan përtej Italisë.³¹ Nga këto del e qartë, se galët bënë pjesë në atë kategori të të shiturish të pabesë, të cilët shumë herë tradhëtuan padronët e tyre. Ka mundësi pra, që ilirët të kenë bërë marrëveshje me grupin e pabesë të Foinikës që më parë, para se të arrinin në port. Në këtë rast marshimi i ilirëve do të kishte shenja të para-marra nga lart, të përgatitura, gjë që pikërisht kemi ndërmend ta vërtetojnë.

Pas pushtimit të Foinikës, në Epir hynë ushtritë tokësore ilire nën komandën e Skerdilaidit, vëllait të Agronit. Përpjekjet që bënë epirotët për të marrë përsëri qytetin, përfunduan pa sukses. Gjatë kohës së disfatës së pësuar, një pjesë e tyre ra në luftë, kurse pjesa tjetër gjeti strehim në vendin e atintanëve.³² Gjendja e epirotëve nuk ndryshoi edhe pas arritjes së ndihmës nga etolët dhe ahejët. Këta erdhën me një fuqi të pamjaftueshme dhe iu larguan përpjekjes së hapur, nuk ia dolën në krye të marrin nga ilirët Foinikën dhe as ta shpëtojnë qytetin nga boshatisja, që krijuan ilirët. Përkrahimi i veprimtarisë së ahejëve dhe etolëve në Epir është pra i pamjaftueshëm, dhe kjo bën të dalin shumë dyshime. Del pra pyetja se ahejët e sidomos etolët a ia arritën të takohen me ilirët? Këta të fundit i kishin shumë të freskëta në mendje humbjet që i patën në Medion. Nuk është e pamundur, gjithashtu, se duke përfituar nga trazirat e krijuara me ardhjen e ilirëve në Epir, ata provuan të shkëpusin nga Lidhja e Epirotëve

³⁰ Pol., II, 4. 5.

³¹ Pol., 7.

³² Pol., 5.

dhe disa pjesë të saja, aq më tepër kur dihet se ishin të interesuar për zotërimin e Akarnanisë. Tregon gjithashtu fakti, se pas ngjarjeve në Epir, për t'u matur me ilirët qenë gjithashtu edhe akarnanët, megjithëse këta nuk dalin drejtpërsëdrejti në kontekstin e ngjarjeve, ashtu si i patën para syve rrethet e Foinikës. Si duket etolët, në vend që të shpejtojnë për të ndihmuar epirotët, i ranë Akarnanisë duke provuar ta pushtojnë. Veprimtaria e tillë që drejtuar gjithashtu kundër ilirëve, të cilët jo shumë kohë përpara shpejtuan t'u ndihmojnë akarnanëve. Të tjera mund të ishin motivet e ahejëve. Polibi thotë se ilirët kishin ndërmend ta çfarosnin Peloponezin. Ka fakte, se për t'i çorientuar kundërshtarët, ilirët përhapën lajme se kanë ndërmend t'i vërsulen Peloponezit, gjë që disa herë përpara e kishin bërë, dhe të cilën gjë e aprovojnë edhe të dhënat e tjera.³³ Ilirët përdornin këtë taktikë për ta befusuar armikun. Ahejët, duke pritur sulmin e tyre i koncentronin forcat në Peloponez, kurse epirotët nuk i kushtuan rëndësi përgatitjeve për mbrojtje. Kjo gjë që e papritur për të dy të miqësuarit. Për suksesin e gjithë operacionit në Epir, vendosi pa dyshim fitorja e forcave tokësore ilire, të cilat erdhën këtu nën udhëheqjen e Skerdilaidit. Nuk dha gjë të madhe diversioni i dardanëve, të cilët duke përfituar nga qëndrimi i Skerdilaidit në Epir, dhe duke vepruar sigurisht në marrëveshje me etolët, ia morën Teutës një fis që e kishte nën sundimin e vet. Si duket, ata ishin ardianët. Në lidhje me diversionin e dardanëve, Teuta i dërgoi Skerdilaidit urdhër për t'u tërhequr nga Epiri. Mirëpo ky, para se të largohet nga Epiri ia ktheu epirotëve kryeqytetin e tyre, si dhe qytetarët e tij. Me siguri, tek Teuta erdhën konsulta nga epirotët me qëllim për të lidhur marrëdhënie për marrëveshje. Për marrëveshje erdhën gjithashtu edhe akarnanët. Më vonë, akarnanët dhe epirotët u ndihmuan ilirëve në luftërat e tyre me ahejët dhe me etolët.³⁴ Duket e qartë se akarnanët dhe epirotët më tepër u frikësoheshin etolëve se sa ilirëve. Pas ngjarjeve në Epir, Teuta filloi të shtypë menjëherë kryengritjet e ardianëve, që ka mundësi të ketë pasur nën sundimin e vet, e të cilët kaluan në anën e dardanëve. Shtypja e kryengritjes dihet, duhej të kalonte në fitore me përpjekjet me dardanët. Pas këtyre ngjarjeve, Teuta filloi rrethimin e ishullit Isa, meqë i vetmi ky kundërshtonte nënshtrimin.³⁵ Marshimi i Teutës për në Epir përfundoi me një fitore të plotë militare dhe me sukses të mrekullueshëm politik. Kjo fitore tregon shenja të marrjes së masave me kujdes dhe të planifikuara, të përcjella deri në fund në mënyrë konsekuente dhe të suksesshme. Nuk ka këtu fjalë për ndonjë gjë të rastit, siç sugjeron rrëfimi i Polibit. Mundësitë e krijuara e veçanërisht fakti se romakët u hodhën kundër ilirëve, bënë që rezultatet e marshimit për në Epir të kenë rëndësi vendimtare. Megjithëkëtë, deri sa të kalojmë në problemin e vetë zhvillimit të luftës,

³³ Sulmet e ilirëve mbi Lakoni i përmend gjithashtu Kleomeni, mbret i Spartës, barazo Plutarchi, *Vitae parallelae*. Ed. C. Sintenis. Lipsiae 1881. *Vita Kleomenii* 10.

³⁴ Pol., II, 6.

³⁵ Pol., II, 6.

ndjekjes së saj dhe të përfundimeve që solli ajo, duhet të llogarisim në rezultatet e kërkimeve lidhur me karakterin e ndryshimeve politike të cilat u panë në gjysmën e dytë të shekullit të II p.e.sonë në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Atëherë ky problem dhe shkaqet e luftës do të dalin edhe më të qarta.

Polibi rrëfen, megjithëse nuk i përcakton rrethanat në të cilat ajo u realizua, se Agroni kishte fuqinë më të madhe detare dhe tokësore ndër të gjithë sunduesit e tjerë që sunduan para tij mbi Ilirinë. Duke plotësuar të dhënat e tij mund të shtojmë se fuqia detare e Agronit u realizua në një situatë të favorshme ndërkombëtare, të cilën e përbënin shkatërrimi i fuqisë detare të Sirakuzës pas Agathoklit, dhe më vonë pas vdekjes së Pirros, shkatërrimi i fuqisë së aiakidëve në det. Kështu pra, rreth gjysmës së shekullit të III para erës sonë nuk kishte fuqi të tjera të cilat do të ishin në gjendje t'i përballonin rritjes së rëndësisë së ilirëve në det. Nën udhëheqjen e Agronit, bile ka mundësi qysh në kohën e Mytilit dhe Pleuratit, të atit të Agronit, ata të njihen si fuqi. Banorët e ishujve adriatikë qenë të njohur si lundruer më të mirë. Nga ata „më vonë romakët përvetësuan tipin e shpejtë dhe të lehtë të anijeve që quheshin liburnike. Zotërimi mbi ishujt dhe flota e madhe iu mundësuan ilirëve të zhvillojnë luftë të gjatë dhe të suksesshme kundër ahejëve, e cila u realizua nga ata me anë të sulmeve mbi Messeninë dhe Eleenë. Siç duket, si shkas i luftës së ilirëve me ahejët qenë shkaqet politike. Vetëm pak më vonë apollonianët /pojanët?/, epidanët dhe korkyrasit të rrezikuar nga Teuta, kërkojnë ndihmë pikërisht nga ahejët.³⁶ Banorët e ishullit Isa, që si duket ishin më të rafinuarit, hidhen nën mbrojtjen e Romës. Si duket ilirët sulmonin ahejët pikërisht pse ata formonin një farë mburoje mbrojtëse për qendrat greke në Iliri. Drejtimi dhe ndeshja e ilirëve në Peloponez i tregon ata mjaft të fuqishëm në det. Kjo superfuqi shumë herë qe demonstruar.

Jo më pak suksese ilirët patën në tokë. Rritjes së rëndësisë së tyre i ndihmoi rënia e Maqedonisë pas invazionit kelt si dhe shpërthimi i shpejtë i Monarkisë së aiakidëve pas vdekjes së Pirros. Mbi madhërinë e ilirëve në vitet e 30-ta të shekullit të III para erës sonë dëshmon fakti, se dardanët, të cilët në luftë me paionët arritën t'ia kalojnë Maqedonisë, duke i mundur ata, në rivalitetin përse i përket sundimit mbi ardianët, ngelën prapa nga ilirët, gjë që këta të fundit ia arritën vetëm në saje të fuqisë së madhe militare që kishin në atë kohë. Thyerja e Monarkisë së aiakidëve pas vdekjes së Deidameas i hapi Agronit rrugë për rikthimin e fuqisë së ilirëve në territorin e ish Mbretërisë së taulantëve dhe në shtetin e atintanëve, të cilat në kohën e Bardhylit të I bënë pjesë në Monarkinë ilire, më vonë ata hynë në Monarkinë e argeadëve, e në fund, në kohën e Pirros u futën në Monarkinë e aiakidëve. Rrugën për në Epir e hapi gjithashtu fitorja mbi etolët në Medion. Si përfundim i kësaj fitorjeje qe hedhja e ilirëve në Epir, me anën e të cilës u arrit marrëveshja në mes të epirotëve dhe akarnanëve

³⁶ Pol, II, 9. 10.

me ilirët. Me këte procesi i integritit të shteteve ballkanike që gjendeshin buzë Detit Jon dhe atij Adriatik rreth qendrës së Shkodrës, i arriti apogeu. Përpara takimit në Epir, autoritetin e udhëheqësve ilirë e kishin njohur dalmatët, ardianët dhe arintanët, kurse pas takimit autoriteti i tyre u njoh edhe nga epirotët dhe akarnanët. Duhet të shtohet, se disfatë pësuan edhe fuqitë e mëdha si ajo e etolëve, e dardanëve dhe pjesërisht ajo e ahejëve. Një rritje të këtillë të rëndësisë së Monarkisë ilire në tokë dhe në det nuk mund të kalonte pa u vënë re nga romakët, të cilët — sipas traditës, sa i përket intervenimit diplomatik të tyre ndaj kontradiktave ndërmjet etolëve dhe akarnanëve — me vëmendje vështruan ngjarjet në Ballkan. Dihet se akoma e kishin ndërmend luftën me Pirron, të cilës nuk qenë në gjendje t'i bënë ballë. Kurse Teuta sa i përket masës sunduese ia tejkalonte Pirros. Para një rritjeje kaq të shpejtë të monarkisë ilire romakët nuk mund të qëndronin indiferentë.

Polibi, si informator kryesor yni, por jo i vetmi sa i përket temës së Luftës së I romake me ilirët, shkaqet e kësaj lufte i bazon tani për tani si vijon: romakët duke patur ndërmend t'i japin fund veprimtarisë së ilirëve, të cilët, si duket, duke lëvizur rreth Foinikës sulmonin gjithashtu dhe tregtarët italianë, i dërguan Teutës përfaqësues të tyre për të kuptuar arsyen e sulmeve. Në krye të këtij delegacioni qenë vëllezërit Korongani. Gjatë kohës së bisedës me ta, mbretëresha e ilirëve shtroi dy çështje të rëndësishme:

1) do të përpiqet, që nga ana e shtetit ilir, Romës mos t'i ndodhë asgjë e keqe e as ndonjë rrezik tjetër.

2) mirëpo, sa i përket personave privatë, mbretërit nuk e kanë zakon t'u përzihen e t'i pengojnë në fitimet që ilirët nxjerrin nga deti.

Anëtari më i ri në moshë i delegacionit, i nevrikosur nga të thënat e Teutës, i përgjigjet me këto fjalë:

„Romakët, Teutë, kanë një zakon shumë të bukur, që dëmet private i dënojnë në mënyrë publike, dhe i shpërblejmë mirë të dëmtuarit. Pra, do të provojmë me dëshirën e shenjtë, për një kohë të shkurtër, të detyrojmë ty, që zakonet mbretërore sa i përket ilirëve të ndërrohen e përmirësohen.”

Më vonë Teuta, e zemëruar nga shprehja e delegatit të ri, kishte dërguar vrasësit pas delegacionit, të cilët edhe e vranë folësin kryelartë. Romakët, me marrjen e lajmit për këtë padrejtësi i nisën menjëherë përgatitjet për luftë tokësore dhe detare.³⁷ Hulumtuesi shkencor, i cili do të njihte si shkak të luftës këto të dhëna nga Polibi, do të lente prapa të drejtën historike. Siç duket, Polibi me tendencë „thekson piraterinë e tyre, duke e quajtur gjoja si bazë kryesore të veprimtarisë së tyre, e cila përbënte rrezikun e botës greke dhe interesave të Romës. Duke patur parasysh konceptin e historiografisë romake të formuluar nga KV. F. Piktora”,³⁸ ai provon t'i japë veprimit të romakëve karakter të një misioni specifik për të

³⁷ Pol., II, 8.

³⁸ M. G e l z e r, *Römische Politik bei Fabius Pictor*. W. „Hermes” 68, 1933, s. 142-146.

mbrojtur normat e bashkëjetesës ndërkombëtare, të shkelura nga piratëria ilire, gjë që u paraqit nga delegati romak. Qëllimi i kësaj paraqitjeje është sigurisht largimi nga thelbi i ngjarjeve, në të cilat rol të rëndësishëm luanin ilirët. Porse ky lloj i paraqitjes së çështjeve, nuk është në gjendje t'i mbulojë të dhënat me kuptim të plotë të fakteve të mësipërme të paraqitura nga ai vetë. Polibi vetë na jep të dhëna të cilat i hedhin poshtë vlerësimet e ngjarjeve nga ai. Kështu, ai merr përsipër shumë dyshime, të cilat nuk i çon deri në fund. Shumica e këtyre gjërave tregojnë mirë orientimin e tij në të gjitha çështjet që kanë lidhje me luftën e diskutuar të romakëve me ilirët. Në fillim të bën të mendosh për luftërat e vazhdueshme të ilirëve me ahejët. Del pyetja, pse e fillon këtë çështje dhe nuk e çon deri në fund? Ai këtë punë e bën para se gjithash që t'u përkujtojë grekëve, gjë që në kohët e fundit vazhdimisht e bën, rrezikun që u kërcënohet atyre nga ilirët, me qëllim që të dalë sa më e qartë rëndësia e madhe e misionit që mori përsipër Roma, për t'iu kërcënuar ilirëve. Mund t'i pranojmë deri diku arsyet që i thekson veçanërisht Polibi si grabitjet dhe vjedhjet, e që në të vërtetë mjaftojnë si shkak të luftës pothuaj permanente të ilirëve me ahejët. Sikur që e dimë, grabitja dhe vjedhja janë shkaqe kryesore në qëllimin e luftës, e piratëria është pra e vetmja mënyrë për realizimin e saj. Mirëpo, nuk është e vërtetë, se vetëm ilirët i sulmonin tregëtarët italianë në Epir. Pse pra tek Polibi zgjerohet tema e ushtarëve galë, të cilët i gjykon në aspektin e vetëdijes dhe besës? A mos galët, duke hyrë në marrëveshje me ilirët dhe duke u dhënë në besim kujdesin e qytetit, harruan zakonet dhe praktikën e përdorur më parë për shkak të të cilave romakët pas Luftës së I punike i dëbuan ata nga Italia? Ka pak të ngjarë, se ata morën pjesë aktive në sulmet mbi tregëtarët italianë, po këto sulme e grabitje në Epir nuk ishin vetëm vepër e tyre aq më tepër kur mbretëresha qartë u shpreh, se do të përpiqej që nga ana e ilirëve, të mos u ndodhë asnjë e keqe romakëve. Me fjalë të tjera, mbretëresha tregohet e matur dhe me vullnet të mirë për të mbajtur marrëdhënie të mira me romakët, duke paraqitur njëkohësisht se sa u përket personave privatë, mbretërit ilirë nuk e kanë zakon t'ua ndalojnë ilirëve fitimet në det, d.m.th. piratërinë private, gjë që pasqyron një zakon të çuditshëm ilir, dhe është specifike për arsye se shërben si bazë për pasurimin e aristokratëve. Mbretëresha duket se në këtë mënyrë e ndan krejt çështjen e përgjegjësisë së ngjarjeve që ndodhën në Epir. Ndërmjet piratërisë private dhe sulmit në Epir del një diferencë esenciale, se në të parën, mbretërit kishin një influencë minimale, kurse sulmi në Epir që i planifikuar dhe i organizuar më parë nga shteti ilir, qëllimi i të cilit që që t'i detyronte epirotët t'i bashkoheshin ilirëve. Ishte pra ky sulm i bërë me qëllim politik. Më në fund është e çuditshme çështja e daljes në pritë delegacionit, e cila — sikur të mbështeteshim vetëm në informatat e Polibit — do të dilte se ndodhi me urdhërin e Teutës. Mirëpo, atë kohë, ka pak të ngjarë që Teuta me të vërtetë të jepte një urdhër të tillë. Kjo çështje del krejt e ndryshme sipas të dhënave të Apianit dhe autorëve të tjerë.

Tregimi i Apianit është i varfër përse i përket hollësirave: disa fakte të dhëna nga ai janë të bazuara në lajme jo të sigurta, të tjera mbeten në kundërshtim me ato që shënon Polibi, por ka edhe fakte të reja, të pashënuara tek Polibi. Të gjitha të dhënave të tij u mungon ana negative, e cila gjendet në tërësi tek Polibi. Apiani u bazua në burime të ndryshme, por kryesisht në paraqitjen e traditave greke.³⁹ Përse i përket fakteve të bazuara në informata jo të sigurta folëm më sipër. Fjala ishte për vendin e formimit të Mbretërisë së Agronit, të cilën Apiani gabimisht e identifikoi me territorin e ish Mbretërisë së taulantëve, e cila që diçka krejt e ndryshme nga Mbretëria ilire. Po kështu nuk i përgjigjet të vërtetës lajmi se Agroni zaptoi ishullin Korkyra sot (Korfuzi). Nëqoftëse mori Korkyrën, ndoshta është fjala për atë të Zezën, që ndodhi përkundrejt bregut të Dalmacisë. Po kështu Agroni nuk e mori Epirin. Në orbitën e ndikimit këtë e tërhoqi më vonë Teuta. Tek Apiani mungojnë shënime mbi temën e luftërave të ilirëve me dardanët, me ahejët dhe me etolët. Ky fakt është i pa shënuar tek Polibi — kurse tek Apiani gjendet shënimi, se ishulli Isa qysh në kohë kur jetonte Agroni, u dha nën kujdesin e romakëve. Romakët dhe banorët e Isës dërguan tek Agroni një delegacion të cilin e sulmuan ilirët, me ç'rast vranë një delegat romak dhe një isas. Delegatët e tjerë shpëtuan, por nuk arritën te Agroni, i cili në atë kohë vdiq. Si pasojë të këtyre ngjarjeve romakët dërguan kundër ilirëve ushtrinë dhe flotën.⁴⁰ Kështu del se sikur t'i gjykonim ngjarjet sipas të dhënave të Apianit, delegacioni nuk arriti tek mbreti i ilirëve. Delegacioni romak u nis tek Agroni për shkak të lutjes së isasve. Nga të dhënat e Apianit dalin dy çështje; se isasit nën kujdesin e romakëve iu nënshtruan ekspansionit të ilirëve nga frika, ndërsa piratëria e tyre ishte gjë e radhës së dytë.

Pak më ndryshe, megjithëqë shumë të dhëna përputhen me ato të Polibit dhe Apianit, shkaqet e luftës tek Dion Kasi dhe Joan Zonara dalin kështu: Isa u dha nën mbrojtjen e romakëve. Këta duke shpejtuar për t'i ardhur në ndihmë kësaj u përpoqën t'i dënojnë në të njëjtën kohë edhe piratët ilirë, gjoja ardianët, për plaçkitjet e tyre të bëra tregtarëve italianë, që lundronin nga Brindisi në Greqi. Delegacionin romak e priti Teuta, e cila disa i burgosi ndërsa disa të tjerë urdhëroi t'i vrasin.⁴¹ Zënien e delegacionit dhe vdekjen e njërit ose të dy anëtarëve të saj e shënojnë dhe autorë të tjerë.⁴²

Të gjitha të dhënat e përmendura këtu dëshmojnë për sulmin e bërë delegacionit, mirëpo çdonjëri e komenton ndryshe. Siç duket, thelbi i çështjes qëndron te institucioni i piratërisë private. Si do që të kishte ndodhur, fakti i sulmit të delegacionit që pretendim i mrekullueshëm për

³⁹ M. G e l z e r, *op. cit.*, s. 142-146.

⁴⁰ App., III. 7.

⁴¹ Dio Cass., XII frg. 49, 2; J. Zonar, VIII, 19, 3.

⁴² Liv., Per. XX; Flor., I, 21; Plin., NH XXXIV, 24.

shpalljen e luftës. Kurse në realitet shkaku i vërtetë dhe motivi për luftë qe nevoja e shkatërrimit të Monarkisë ilire që po rritej dukshëm.

Duke studiuar shkaqet e Luftës së I të romakëve me ilirët, ata harrojnë ose nuk i japin rëndësi fjalëve të fundit të fjalimit të delegatit (konsullit) romak, me të cilat ai i shpalli luftë Teutës. Prandaj çdo hap i marrë nga Teuta e hedh poshtë mendimin lidhur me dëshirën e saj për sulmin ndaj delegacionit, për të cilin flitej, sepse përgatitjet qenë ndërmarrë për mbrojtjen e shtetit të saj. Me siguri, ajo i habiti romakët me ofensivën e saj të planifikuar dhe të zhvilluar shpejt në det. Flota e saj u gjend pothuajse menjëherë kudo përgjatë bregut të Detit Adriatik dhe atij Jon. Nga eskadra që lundronte në jug kundër Korkyrës /Korfuzit/ shkëputet një njësit dhe në marsh e sipër provon të zaptojë Epidamin. Ilirët provojnë ta marrin dhe Apolloninë. Flota e Teutës me një sulm shumë të shpejtë merr portin në Korkyrë. Të habitur epidamnët, korkyrët dhe apolloniatët, dërgojnë një delegacion tek ahejët dhe etolët që t'u vijnë në ndihmë. Në luftë eskadra e ilirëve, duke patur në ndihmë eskadrën e akarnanëve, shkatërron eskadrën e formuar nga anijet e ahejëve, të etolëve dhe të korkyrëve. Korkyrët duke mos patur shpresë për shpëtim, të demoralizuar, pranojnë njësitet ilire në krye me Demetrin e Farit, një nga komandantët e Teutës. Fuqitë e Teutës, duke qenë të lirë nga operacioni me Korkyrën hidhen në Epidam i cili është tani i rrethuar nga ana tokësore dhe detare.⁴³ Rënia e Epidamit, Apollonisë dhe Isës, ishte tani çështje dite. Teuta nuk qe lajmëruar për çështje rrethimi. Romakët, kur morën vesh për rënien e Korkyrës dhe duke patur më përpara lajme mbi rrethimin e Isës, në pranverën e vitit 229⁴⁴ me të shpejtë dërgojnë eskadrën e papërgatitur mirë, të përbërë nga 200 anije vijore, nga ato të cilat i siguruan fitore në Luftën e I punike. Ushtrinë tokësore, me një fuqi prej 20.000 këmbësorësh dhe 2000 kalorësish e hodhën pak më vonë, duke i zbarkuar në Apolloni dhe Epidamn. Romakët i përballuan taktikës së Teutës me një taktikë të forcës së koncentruar në disa pika të zgjedhura për sulme, në të cilat Teuta, të paktën nga deti, qe zënë në dobësi. Romakët e morën Korkyrën vetëm për shkak të tradhëtisë së Demetër Farit, i cili e la Teutën megjithëqë, qe i pajtuar me pagesë tek ajo.⁴⁵ Ka mundësi që agjentët romakë, në marrëveshje me Demetrin e Farit, përgatitën njëfarë veprimtarie kundër flotës së përhershme nga ilirët.⁴⁶ Si do që të ishte përgatitja e tradhtisë, qëndron fakti se eskadra romake që më parë u paraqit në Korkyrë, gjë që ishte e papritur për njësitë ilire që qëndronin në vend. Rënia e Korkyrës i lehtësoi mjaft

⁴³ Pol., II, 9, 10.

⁴⁴ Mbi çështjen e datave barazo: M. H o l l e a u x, *La date de la première guerre d'Illyrie*. W: „Revue des Etudes Grecques”, t. 43, 1930, s. 243 in.; G. W al s e r, sipas sipër s. 312.

⁴⁵ Pol., II, 11.

⁴⁶ Sipas G. W a l s e r a, *Die Ursachen des ersten römisch — illyrischen Krieges* W: „Historia”, 2, 1952-1954, s. 317; Demetri e planifikoi tradhëtinë qysh përpara, për të cilën gjë i lajmëroi romakët, prandaj eskadra e tyre më parë u drejtua në Korkyrë.

punë anës romake për t'ia arritur qëllimit të saj më vonë. Eskadra romake, tani në krye me Demetrin e Farit, arrin menjëherë në Apolloni, e pastaj në Epidam. Apollonianët iu dorëzuan romakëve. Në Epidam romakët filluan luftën me ilirët me të cilët ishte i mbushur qyteti.⁴⁷ Ky, si dhe fqinjët e tij, Partha dhe Atintana ranë në duart e Romës. Duke u futur më tutje në pikat e zëna d.m.th. që nga Epidami e më thellë në rajone ilire, romakët arrinë tek ardianët, të cilët i mundin. Duket qartë se në periudhën e sulmit romak, ardianët u shkëputën nga Teuta. Në anën tjetër, eskadra romake duke operuar në Adriatik lundroi në ishullin Isa, duke shkëputur blokadën e ishullit dhe të qytetit. Ata pa mundim e nënshtruan ishullin e Farit. Në tokë romakët gjetën një rezistencë të fortë nën Nutria ose Atyri, ku patën humbje të mëdha.⁴⁸ Pas këtyre ngjarjeve Teuta u mbrojt në Rizon. Një nga kryetarët romakë, G. Fulviu, u kthye në Romë për të festuar fitoren mbi ilirët,⁴⁹ kurse një tjetër, A. Postumiu, mbeti në Iliri, në Epidamn, për t'u kujdesur për popujt e mundur nga romakët si dhe për ata që vetë iu dorëzuan kujdesit të tyre.⁵⁰

Pak më ndryshe e paraqesin zhvillimin e luftës Apiani dhe Dion — Kasi; sipas të parit Demetri i Farit ua dorëzoi romakëve Korkyrën dhe Farin,⁵¹ i dyti shkruan, se Demetri e tradhtoi Teutën pas disfatës së ilirëve nën Atyri.⁵²

Kështu paraqitej zhvillimi i Luftës së I romake me ilirët. Është gjë e qartë, se më tepër na interesojnë rezultatet e saj.

Në pranverën e vitit 228 në Romë arriti delegacioni i Teutës. Ilirët u detyruan të paguajnë shumë e caktuar, t'i kthejnë robërit dhe të arratisurit, dhe të largohen nga e gjithë Iliria në pjesën jugore të Lisit. Përveç këtyre, ilirët nuk e kishin të lirë të lundronin në jug të Lisit me më tepër se dy anije. Sa i përket Demetrin të Farit, sipas Polibit, si shpërblim për shërbimin që u bëri romakëve, ata i siguruan sundim mbi pjesën më të madhe të ilirëve.⁵³ Kurse Apiani thotë, se besnikëria e tij ishte e dyshimtë, atij iu dhanë vetëm disa qytete,⁵⁴ ndërsa romakët i garantuan vetes sundimin mbi Apolloninë, Farin, Korkyrën, Epidamnin, Atintanën dhe, me siguri, mbi Parthinën. Në pjesën tjetër të shtetit të Agronit do të sundonte i biri i tij, Pini.⁵⁵ Si shihet më sipër, fituesit nuk kishin ndërmend të toleronin më tutje sundimin e shtetit të Teutës, e cila, pas marrëveshjes e dorëzoi sundimin e saj.⁵⁶ Monarkisë ilire të mundur iu imponua statuti i

⁴⁷ Pol., II, 11.

⁴⁸ Pol., II, 12; dio Cass., XII frg 49.

⁴⁹ *Corpus Inscriptionum Latinarum*, vol. I, nr. 458.

⁵⁰ Pol., II, 12.

⁵¹ App., III. 7.

⁵² Dio Cass., XII, frg. 49.

⁵³ Pol., II, 12.

⁵⁴ App., III. 7. 8.

⁵⁵ App., III. 7. 8.

⁵⁶ Dio Cass., XII, frg. 49. Florus II, 5 thotë se është pak e besueshme tradita se gjoja romakët e dënuan T e u t ë n me prerje të kokës me tasat, gjë që kishte ndodhë në Romë.

shtetit të varur, sikundër Kartagjenës pas Luftës së II punike, dhe Maqedonisë pas Luftës së II maqedone. Duke patur parasysh ngjarjet e mëvonshme, më tepër rëndësi patën kontradiktat territoriale. Siç duket, romakët haptas nxitonin të zotëronin vendin e ardianëve. Marshi romak në thellësi të Ilirisë duket se kishte dy qëllime: që të mos i lejonin dardanët ose maqedonasit eventualisht të bashkëpunonin në luftë për tokën e lënë në trashëgim (scheda), pas shpartallimit të Monarkisë ilire, sepse maqedonasit, të paktën mund të shtonin pretendimet e tyre për territoret e taulantëve dhe atintanëve, që dikur kishin qenë të varura nga sundimi i Filipit të II dhe Aleksandrit të Madh. Në anën tjetër dardanët, të cilët sundonin Paioninë, sundonin gjithashtu dhe mbi ardianët. Duke i thyer ardianët, romakët përfituan nga kjo situatë e mrekullueshme për luftë të ardhshme dhe të planifikuar me Maqedoninë. Nga territori i ardianëve ata mund të vështronin zhvillimin e ngjarjeve në Dardani, dhe njëkohësisht kishin parasysh çështjet e brendshme të ndërlikuara të Mbretërisë së ilirëve. Derisa ekzistonte shteti i maqedonëve dhe ai i ilirëve, romakët si mjet të kontraditave ndërmjet tyre kishin shtetin e ardianëve. Se romakët donin ta arrinin këtë gjendje të zhvillimit të ngjarjeve, flasin ngjarjet e kohës, të shkaktuara nga veprimet e Demetrit nga Fari, i cili gjatë kësaj kohe ia ktheu shpinën Romës, duke u hedhur në anën e Maqedonisë. Në atë kohë shteti i ardianëve u shkëput nga Roma. Kjo ngjarje ishte një nga shkaqet për të cilat romakët përsëri u hodhën në Iliri. Pas kësaj lufte, romakët ia dhanë, siç duket, sundimin mbi vendin e ardianëve Skerdialaidit, sunduesit të ilirëve, më vonë ilirëve këtë ia morën maqedonasit.⁵⁷

Jo më pak rëndësi për romakët pati sundimi mbi vendin e atintanëve. Nga territori i tyre romakët synonin në çështjet e brendshme të Epirit, duke mos cekur më kontrollin e situatës në Maqedoni dhe Iliri. Rëndësi krejt të veçantë për Romën pati fakti i zaptimit të Epidamnit, të Parthit dhe të Apollonisë. Nga pushtimi i Apollonisë dhe Epidamit, Roma nuk rezignoi bile as në kohë kur në Itali ndodhi çështja dramatike me Hanibalin, kurse në Iliri Filipi i V filloi ofensivën që mbaroi me sukses të madh për te.

Siç shihet më sipër, sa i përket territoreve pas Luftës së I më ilirët, Roma e drejtoi në atë mënyrë aktivitetin e vet, që do t'i sigurojë asaj të drejtën e çështjeve të brendshme të të gjitha vendeve ballkanike, duke përfshirë edhe vetë shtetin e ilirëve. Duke pasur pra nën kujdes Apolloninë, Epidamnin dhe Parthin, dhe duke sunduar mbi vendet e atintanëve, taulantëve dhe ardianëve, romakët kryenin kontrollin e plotë mbi territorin që nga Adriatiku gjer në Maqedoni dhe Dardani, nga Iliria gjer në Epir. Ata nuk bënë likuidimin e plotë të shtetit të ilirëve, sepse, ai akoma, në të ardhmen, do të luajë një rol miqësie në luftë me Maqedoninë. Kështu Roma, e cila në vitin 229 zinte vetëm pozitën e vëzhguesit të ngjarjeve në

⁵⁷ Liv., XXVII, 30.

Gadishullin Ballkanik, si rezultat i Luftës së I me ilirët, në ngjarjet e mëvonshme ajo qëndroi si stimulator i situatës që ekzistonte këtu.

Pas fitores mbi ilirët A. Postumi dërgoi një delegacion tek ahejët dhe etolët me informata mbi ngjarjet e zhvilluara. Grekët shprehën kënaqësi për shkatërrimin i ilirëve, duke i parë ata gjithmonë si piratë. Në Korinth, ku erdhi delegacioni romak, morën vendim për pranimin e romakëve në lojërat istmike.⁵⁸ Athenasit më vonë ua njohën të drejtën romakëve për të marrë pjesë në misteret eleuziane dhe ispolite.⁵⁹ Në këtë mënyrë grekët i njohën romakët të barabartë me veten e tyre, por në të njëjtën kohë asgjë nuk i pengonte t'i quajnë akoma barbarë.⁶⁰ Mirëpo, delegacioni, përveç çfaqjes së ndjenjave miqësore karshi grekëve,⁶¹ kishte edhe një qëllim: manifestimin antimaqedon. Në të vërtetë, Maqedonia në kohën e Luftës së I romake me ilirët, kaloi disa vështirësi të brendshme të lidhura me humbjen që patën në luftë me dardanët, dhe në lidhje me ndërrimin e udhëheqësit, kështu që nuk mund të merrte pjesë aktive në ngjarjet në terrenin e Ilirisë. Mirëpo, pasardhësi i Demetrit të II, Antigon Dostoni menjëherë filloi energjikisht ta imponojë influencën maqedone në Greqi, të cilën gjë dhe e arriti. Për një kohë të shkurtër, pas Luftës në Selasi, në Iliri filluan trazira të brendshme të shkaktuara nga Demetri i Farit dhe kundërshtari i tij Skerdilaidi, rezultat i të cilave qe Lufta e II e romakëve në Iliri. Në morinë e shkaqeve, në të cilat e bazon këtë luftë Polibi ai fajëson edhe Demetrit e Farit se „... të gjitha shpresat e tij i kishte vënë te maqedonasit, meqë bashkë me Antigon Dostonin ia nisi luftës kundër Kleomenit”.⁶² Është gjë e qartë, se përveç iniciativës së vet Demetri i Farit veproi edhe sipas inspirimit maqedon, gjë që do të faktonte aktivitetin e Antigon Dostonit, i cili pasi i doli zot Kleomenit kishte ndërmend ta zhvillonte më vonë influencën maqedone në Iliri. Ky konkluzion i fundit përforcon pikëpamjen e ngritur më lart, dhe se delegacioni romak tek grekët përcakton gjithashtu demonstrimin antimaqedon. Pas shkatërrimit të shtetit të ilirëve nga romakët, maqedonasit përveç romakëve, nuk gjetën më kundërshtarë të barabartë.

Në këto rrethana dhe në mënyrë të përshkruar më sipër, romakët bënë hapin e parë në rrugën e nënshtrimit të Lindjes helenistike.

⁵⁸ Pol., II, 12.


⁵⁹ Zonar., VIII, 19.

⁶⁰ Pol., IX, 37.

⁶¹ G. W a l s e r, *op. cit.*, s. 315; M. G e l z e r, *op. cit.*, s. 132.

⁶² Pol., III, 16.

ILIRIA NË KOHËN E LUFTËS SË PARË ME ROMAKËT



Teksti i legjendës:

1. Sipërfaqja fillestare e shtetit të ilirëve në kohën e Agronit dhe të Teutës
2. Sipërfaqet e sunduara nga ilirët (në kohën e Teutës)
3. Drejtimet e ekspeditës së ilirëve
4. Drejtimi i marshit të romakëve në vitin 229 para erës sonë
5. Terreni i marshit nga Roma mbas vitit 229 para erës sonë
6. Maqedonia në vitin 229 para erës sonë.
7. Mbretëria e dardanëve
8. Terrene të sunduara nga Demetri i Farit në vitin 229

Włodzimierz Pajkowski

LA PREMIÈRE GUERRE DES ROMAINS CONTRE LES ILLYRIENS

R é s u m é

Agroni et Teuta étaient des chefs des illyriens. A la fin de la première guerre romano-illyrienne (229 av. n. e.) l'Etat illyrien existait encore.

En étudiant les causes de la première guerre des romains contre les illyriens on oublie ou on ne tient pas compte aux derniers mots du discours du délégué (consul) romain quand il déclara la guerre à Teuta. Elle s'est préparée pour l'offensive romaine. Sa flotte était toujours dans les bords de la mer Adriatique et ceux de la mer Ionienne. Une unité de la flotte navigant vers la ville de Corcyre se sépara et essaya à envahir la ville d'Epidamnus (aujourd'hui la ville de Durrës). Les Illyriens essayaient à envahir même la ville d'Apollonie (aujourd'hui Pojani). Par une attaque rapide, la flotte de Teuta envahit le port de Corcyre (aujourd'hui Corfou). Les habitants d'Epidamnus, d'Apollonie et de Corcyre envoient les délégations dans le but à aider les ahejs et les éliots. Au cours de la guerre près de Paksoit, la flotte illyrienne aidée par la flotte des acarnans détruisent la flotte commune des ahejs, des étols et des corcyriens. Ces derniers, n'ayant pas d'esperance à se sauver, démoralisés, acceptent à avoir comme chef Demetrius de Fare qui était un des commandant de Teuta. Les forces de Teuta, étant libres des opérations de Corcyre vont vers l'Epidamnus déjà entouré du coté de la terre et de la mer. La chute d'Epidamnus, d'Apollonie et d'Issa était uniquement une question de jour. Ayant appris de la chute de Corcyre et le siège d'Issa, les romains, au printemps de 229 expédièrent rapidement leur flotte non bien préparée. Cette flotte comptait 200 navires. C'était la flotte qu'elle avait assuré la victoire au cours de la première guerre punique. L'armée terrestre comptait 20.000 fantassins et 2000 chevaliers. Ces forces militaires se débarquèrent en Apollonie et à Epidamnus. Les romains firent face à Teuta. Ils occuperent Corcyre grâce à la trahison de Demetrius de Fare qui était le commandant de la flotte illyrienne de Teuta. Par la chute de Corcyre les romains occuperent facilement l'Apollonie, l'Epidamnus ayant toujours comme chef la traître Demetrius de Fare. Plus tard, les romains occuperent la Parthe et l'Athintane ainsi que les ardiens. La flotte romaine naviga vers Issa sans pouvoir envahir l'île de Fare. Les romains eurent de grandes pertes surtout luttant contre Nutria ou Athyres. Apres ces événement Teuta se sauva à Rhizon. Un des chefs des romains se dirigea vers la ville de Roma a célébrer la victoire, tandis que l'autre resta à Epidamnus à s'intéresser pour le sort du peuple envahit par les romains.